



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

26-09-2019

Nr./ organit Org. broj	Numri/Broj	Shtet Prilog	Vlera Vendnos
	1-110/05-1000		



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

RREGULLORE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1, dhe 12.2 shkronja c) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Republikës Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.28/2008, nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me neni 9 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/2008, në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 36.2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën: 26.09.2019, merr këtë:

RREGULLORE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

KAPITULLI 1

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore caktohet lartësia e taksave (tarifave), ngarkesave dhe gjobave për shërbime nga veprimtaritë komunale, që do të paguajnë personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe tregtare, lejeve për punë profesionale, për pronësi të automjeteve, të përdorimit apo shfrytëzimit të pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, për shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale.

Neni 2

Komuna mbledh këto të hyra komunale:

- Tatimi në pronën e paluajtshme. (Të hyrat nga tatimi në pronë përcaktohen me rregullore të veçantë).
- Tarifat për Shërbimet administrative komunale,
- Ngarkesat për shërbimet komunale,
- Gjobat në trafik dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale, dhe
- Të hyra të tjera të lejuara me ligj.

Neni 3

Kjo rregullore përcakton organin që inkason të hyrat komunale, nivelin e pagesës dhe mënyrën e pagesës për secilën taksë administrative dhe ngarkesë komunale. Pagesa për shërbimet që i kryen komuna ndaj qytetarëve janë vendosur në pajtim me parimet e mbulimit të shpenzimeve, duke përfshirë shpenzimet për punë, material, transport etj.

Pagesa për kryerjen e shërbimeve administrative komunale (taksave, ngarkesave dhe detyrimeve) bëhet në valutë, e cila është e aplikueshme si mjet pagese në Kosovë.

Neni 4

Lartësia e taksave dhe ngarkesave

Lartësia e taksave dhe ngarkesave që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që ju ofrohen do të caktohen sipas drejtorive përkatëse.

Neni 5
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare.

Nr.	Shërbimet (dokumenti)	Lartësia e taksës €
5.1	Lëshimi i certifikatës së lindjes, ekstratit të lindjes, martesës	1.00
5.2	Lëshimi i certifikatës mbi statusin martesor	2.00
5.3	Procedura- ceremonia e kurorëzimit	7.00
5.4	Kurorëzimi jashtë orarit të punës dhe jashtë selisë së organit 30 euro.	30,00
5.5	Lëshimi i certifikatës mbi vendbanimin	1.00
5.6	Përpilimi dhe lëshimi i Aktvdekjeve	3.00
5.7	Lëshimi i certifikatës familjare	2.00
5.8	Lëshimi i certifikatës mbi shtetësinë	2.00
5.9	Lëshimi i vërtetimit mbi vendqëndrimin	2.00
5.10	Vërtetimi që personi i caktuar nuk është banor i Vitisë	2.00
5.11	Vërtetimi mbi varshmërinë materiale nga personi i caktuar	2.00
5.12	Përpilimi dhe lëshimi i deklaratave me dëshmitar	1.00
5.13	Vendimi mbi regjistrimin e më vonshme në LAL, LAM dhe LAV	3.00
5.14	Vendimi mbi ndryshimet e mëvonshme në LAL, LAM dhe LAV dhe të tjera	5.00
5.15	Lëshimi i vërtetimit mbi shpenzimet e varrimit	2.00
5.16	Vërtetime për shtetasit tanë me punë dhe vendbanim jashtë Kosovës	3.00
5.17	Për parashtrimin e kërkesës	1,00
5.18	Vërtetime, certifikata të ndryshme të palëve që nuk janë përfshira më lartë	2.00

Neni 6

Nga pagesat për shërbimet e kryera komunale sipas nenit 5.1 deri 5.18 të këtij neni lirohen:

a) Shfrytëzuesit e ndihmës sociale, personat të cilët parashtrajnë kërkesa për ndihmë financiare (subvencione) pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, familjet e Dëshmorëve, Invalidët e luftës, Veteranët e luftës dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushta, familjet e viktimave të luftës, personat me aftësi të kufizuar, Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas (RAE) dhe personat mbi moshën 65 vjeçare, gratë kryefamiljare dhe fëmijët e tyre nën moshën 18 vjeçare.

b) Lirimi nga pagesa e taksës komunale nën a) do të bëhet pasi pala ta paraqes dëshminë mbi statusin përkatës.

c) Pagesat për shërbimet e kryera bëhet në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Vitisë apo te zyrtari i autorizuar i cili obligohet që palës ti jap dëshminë mbi pagesën e bërë.

Neni 6 pika a) vlenë për Drejtorinë e Administratës.

Për zbatimin e nenit 5 dhe 6 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria e Administratës.

Neni 7

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

7.1. Shërbimi i arkivit historik

7.1.1 Kopja e diplomave dhe dëftesave	2.00€
7.1.2 Kopje të projekteve individuale.....	10.00€
7.1.3 Kopje të materialeve të vjetruara arkivore dhe materiale të tjera	5.00€

Neni 8

8.1 Dhënia e sallave publike në shfrytëzim në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”

8.2.1 Dhënia në shfrytëzim e sallës së Kuvendit Komunal për gjysmë dite.....	30€
8.1.2 Dhënia në shfrytëzim e sallës së filmit (teatrit) për gjysmë dite	70€
8.1.3 Dhënia në shfrytëzim e një zyre në pronësi komunale për gjysmë dite	10€
8.1.4 Dhënia në shfrytëzim e Galerisë së Arteve	50€
8.1.5 Dhënia në shfrytëzim e qendrës rinore	40€
8.1.6 Dhënia me qira e zyrave të tjera të shtëpisë së Kulturës do të bëhet me shpallje publike.	

Për zbatimin e nenit 7 dhe 8 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 9

DREJTORIA PËR ARSIM

Institucionet e arsimit parashkollor, arsimit fillor dhe të mesëm, inkasojnë taksë gjegjësisht të hyra për buxhetin e komunës siç vijon:

9.1 Pagesa e taksës për çdo parashkollor në çerdhen e fëmijëve	30€/muaj
9.2 Pagesa e taksës për familjet që kanë dy fëmijë në institucionin parashkollor për të dytin paguan 30% më pak, nëse familja ka 3 fëmijë në institucionin parashkollor, për të tretin paguan 50% të tarifës. Lirohen nga pagesa nënat vetushqyese që janë në marrëdhënie pune.	
9.3 Për duplikat të dëftesës ose diplomës për shkollat fillore dhe të mesme paguhet taksë më sa vijon:	
9.3.1 Për duplikat të dëftesës për shkollat e mesme	1€
9.3.2 Për duplikat të diplomës për shkollat e mesme	1€
9.3.3 Për duplikat të dëftesave në shkolla fillore	1€
9.4 Për arsimin e të rriturve (mësimi jo formal)	
9.4.1 Për regjistrim të vitit (për një klasë).....	100.00€
9.4.2 Për praktik profesionale	50.00€
9.4.3 Provimi diferencial.....	10.00€
9.4.4 Për provimin përfundimtar të klasës, certifikatave.....	30.00€
9.4.5 Për diplomë të përfundimit të shkollimit	20.00€
9.5 Nga neni 9.1 për pagesë lirohen fëmijët e dëshmorëve dhe fëmijët e invalidëve të UÇK-së sipas dëshmimeve të ofruara . Gjithashtu nga taksat lirohen personat me nevoja të veçanta, veteranet e luftës dhe anëtarët e familjes së tyre.	
9.6. Të gjitha të hyrat nga neni 9 i kësaj rregullore sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë duhet të dorëzohen në llogarinë e buxhetit komunal. Për zbatimin e nenit 9 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për Arsim.	

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI

Konform Udhëzimeve Administrative me Nr.08/2014, për tarifën e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme nga zyrat kadastrale komunale dhe Nr.05/2012, për tarifën e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale të ofruara nga zyrat kadastrale komunale dhe kompanitë gjeodete të licencuara të përgatitura nga Ministria për Mjedisi dhe Planifikim Hapësinorë.

Ngarkesat për shërbimet komunale kadastrale:

10.1. Regjistrimi i pronësisë, posedimit dhe të drejtave tjera:

Regjistrimi i pronësisë, posedimit sipas transaksioneve do të bëhet sipas vlerave të transaksioneve të kryera për pronën e paluajtshme.

- Për vlerën e transaksionit deri në 10.000€ paguhet taksa prej 20€
- Për vlerën e transaksionit prej 10.000€ e deri në 30.000€ paguhet taksa prej 30€
- Për vlerën e transaksionit prej 30.000€ e deri 50.000€ paguhet taksa prej 35€
- Për vlerën e transaksionit prej 50.000€ e deri 100.000 € paguhet taksa prej 50€
- Mbi vlerën e 100.000€, për çdo 50.000 € tejkalim, paguhet vlera prej 30€, por shuma e taksës së përgjithshme nuk mund ta kalojë vlerën e 300€.
- Po që se vlera e kontratës-transaksionit është e pa vlerësueshme paguhet taksa në vlerë prej.....70 €.

10.2. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit mbi dhuratën:

- Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës është anëtar i familjes apo pasardhësi i dhuratëdhënësit, është e caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet 30% taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës së përcaktuar me nenin 10.1 të kësaj rregullore.
- Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës nuk janë anëtarët e familjes apo pasardhësit e dhuratëmarrësit, është e caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës së përcaktuar me nenin 10.1 të kësaj rregullore.
- Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës janë anëtarët e familjes së ngushtë dhuratëmarrësit, ndërsa nuk është e caktuar vlera e pronës në kontratë, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumën prej 50€ për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën e mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.
- Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës nuk janë anëtarët e familjes së ngushtë dhuratëmarrësit, ndërsa nuk është e caktuar vlera e pronës në kontratë, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumën prej 80€ për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.

10.3. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë-posedimit.

- Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të Vendimit të organit administrativ apo gjyqësor, bëhet duke paguar taksën-tarifën në shumën prej 50€.

10.4. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës bashkëpronësi

- Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bashkëpronësi bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20€, për një akt juridik me të cilin është vendosur bashkëpronësia.
- Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) fizike të pronës nga bashkëpronësia, pagesa bëhet duke paguar nga 20€ nga secili bashkëpronar që bëhet pronar individual nga pjesëtimi fizik i pronës.
- Për regjistrimin e pronës së përbashkët të bashkëshortëve bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20€ për një akt juridik me të cilin është vendosur prona e përbashkët.

- Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20€.
- Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronarët e pjesëve të veçanta bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 100€.

10.5. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të Trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare

- Regjistrimi i pronësisë, në bazë të Trashëgimisë bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 10€ për çdo trashëgimtar.
- Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 10€ për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar-posedues.

10.6. Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme

- Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme, bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 30€ për secilin pronar-posedues.

10.7. Regjistrimi i hipotekës

Regjistrimi i hipotekave do të bëhet sipas vlerave të kërkesave (kredive) të përcaktuar me dokumentin e hipotekës dhe atë:

- Kërkesa (kredia) në vlerën deri 10.000€, paguhet taksa-tarifa në shumën prej10€
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 10.000€ e deri në 30.000€ paguhet taksa-tarifa në shumën prej20€
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 30.000 € e deri në 50.000 € paguhet taksa-tarifa në shumën prej30 €
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 50.000€ e deri në 100.000€ paguhet taksa –tarifa në shumën prej80 €
- Mbi vlerën e 100.000 €, për çdo 100.000€ tejkalim paguhet edhe nga 30€, por shuma e tarifës-taksës nuk mund ta kaloj vlerën e400€.

10.8. Ndryshimi dhe fshirja e hipotekës

- Ndryshimi i hipotekës së regjistruar bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 30€
- Për fshirjen e hipotekës nga Regjistri i të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 10€.

10.9. Regjistrimi i servituteve

- Regjistrimi i të drejtës së servitutit në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 50€.
- Fshirja e Servitutit nga regjistri bëhet duke paguar tarifën në shumën prej..... 20€.

10.10. Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit - qirambajtja

- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtje me kohëzgjatje prej 3 deri në 10 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumë prej 50 €.
- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtja në kohëzgjatje prej 10 deri në 25 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej 150€.
- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtja me kohëzgjatje deri në 99 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej500 €.
- Për ndryshimin dhe fshirjen e të drejtës së shfrytëzimit - qirambajtja bëhet duke paguar 20% e shumës që është paguar për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit.
- Me rastin e bartjes së të drejtës së shfrytëzimit - qirambajtjes ose nënqiranë tek personat e tretë paguhet tarifa e cila është e përcaktuar me nenin 10.1 dhe 10.2 të kësaj rregullore.

10.11. Regjistri i barrëve dhe ngarkesave të ndryshme

- Për regjistrimin e barrës në tatimin në pronën e paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20€.
- Për regjistrimin e barrës tatimore bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 30€.

- Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkohshme), që procedua gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr me kërkesë private të palës, duhet të paguhet tarifa prej 50€.
 - Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkohshme), që procedua gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr sipas detyrës zyrtare nga një organ kompetent për zbatimin e ligjit (Prokuroria, policia etj) nuk do të paguhet asnjë tarifë.
- 10.12. Korrigjimi i të dhënave në regjistër**
- Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër sipas dokumentacionit të dorëzuar nga palët, korrigjimi i tyre bëhet duke paguar nga pala 20€.
 - Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër me variorimin e Zyrës kadastrale Komunale ose nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, atëherë korrigjimi bëhet pa pagesë.
- 10.13. Regjistrimi i të drejtave tjera**
- Regjistrimi i të drejtave, ngarkesave, barrës pronësore të tjera mbi pronën e paluajtshme e të cilat nuk janë përfshirë në dispozitat e kësaj rregullore do të regjistrohen duke paguar tarifën në shumën prej 40€.
- 10.14. Ndërrimi i kulturave të parcelave:**
- Ndërrimi i kulturës të një parcele pa matje gjeodezike..... 10 €
 - Ndërrimi i kulturës të një parcele me matje bëhet sipas tarifave të përcaktuara me nenin 10.15 të kësaj rregullore.
- 10.15. Ndarja e parcelave**
- Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren deri në 0.50ha.....75€
 - Për çdo ndarje në pjesë tjetër25 €
 - Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren në sipërfaqe 0.50ha – 1.0ha100€
 - Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren në sipërfaqe 1ha – 5.0ha150€
 - Ndarja e një parcele në pjesë të përcaktuara më parë80€
 - Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më parë për çdo pjesë40€
 - Ndarje e komplekseve me sipërfaqe prej 5-10ha në dy pjesë200€
 - Për çdo ndarje në pjesë tjetër100€
 - Ndarja e komplekseve me sipërfaqe mbi 10ha 500€
 - Për çdo ndarje në pjesë tjetër 200€
- 10.16. Bashkimi i parcelave**
- Bashkimi i parcelave pa matje20€
 - Për çdo parcelë tjetër në kufi10€
- 10.17. Matja e ndërtesave:**
- Matja për një ndërtesë individuale për një m² të bazës gjeodezike.....0,50€
 - Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë..... 0,25€
 - Ndërtesa banimi kolektiv për 1m².....0,50€
 - Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m².....0,50€
 - Ndërtesa afariste për 1 m².....0,70€
 - Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1m².....0,70€
 - Ndërtesë banesore-afariste, për 1m².....0,70€
 - Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1m².....0,50€
 - Ndërtesë e administratës qeveritare dhe publike për 1m².....0,50€
 - Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m².....0,50€
 - Objekte për sport dhe rekreacione (stadiume, halla sportive etj) për 1m².....0,50€
 - Objekte kulturore dhe fetare, për 1m².....0,30€

• Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1m ²	0,50€
10.18. Matja e pjesëve të ndërtesave:	
• Hapësirat banesore dhe përpilimi i skicës, për 1m ²	0,80€
• Kati me skicat e njësisve të veçanta për 1m ²	0,70€
• Ndarja e hapësirave banesore dhe përpilimi i skicës, për 1m ²	1,00€
• Ndarja e hapësirës afariste dhe përpilimi i skicës për çdo pjesë, për 1m ²	0,75€
10.19. Matja e përçojave	
• Përçoja nëntokësore, për metër gjatësi	0,50€
• Përçoja mbitokësore, për metër gjatësi	0,25€
• Objekte nëntokësore	100.00€
• Për çdo objekt tjetër.....	50.00€
• Tunelet për metër gjatësi.....	5.00€
10.20. Përcaktimi i kufijve të parcelave	
• Për një parcelë me sipërfaqe gjerë 0.50ha	80.00€
• Për një parcelë me sipërfaqe prej 0.50ha – 1.00ha	100.00€
• Për çdo parcelë tjetër mbi 1ha	60.00€
• Për parcelat urbane sipas Planit Urbanistik (pas marrjes së pëlqimit nga Drejtoria e Urbanizmit	120.00€
10.21. Rirregullimi i kufijve të parcelave	
• Për një parcelë me sipërfaqe prej gjer 0.50ha.....	40.00€
• Për parcelë me sipërfaqe prej 0.50ha-1.00ha	50.00€
• Për çdo parcelë tjetër me sipërfaqe mbi 1.00ha	30.00€
10.22. Dhënia e dëshmime në bazë të dhënave kadastrave tekstuale apo grafike sipas kërkesave të palëve nga ZKK	
• Dhënia e vërtetimeve të ndryshme	3,00€
• Çertifikata mbi pronën	4,00€
• Kopja e planit për një parcelë	5,00€
• Për çdo parcelë tjetër.....	2,00€
• Historiati për një parcelë.....	30,00€
10.23. Punët e zyrës sipas kërkesave të palëve	
• Identifikimi i njësive kadastrave në teren për njësi të kadastrave	20,00€
• Për çdo njësi tjetër në kufi.....	5,00€
• Kontrollimi dhe regjistrimi në regjistër i të dhënave nga terreni për njësi	20,00€
10.24. Punët e veçanta gjeodezike	
• Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objekt individual për m ²	0.50€
• Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objekt banimi kolektiv apo afarist për m ²	0,50€.
10.25. Baza gjeodezike	
Pikat trigonometrike:	
• Koordinatat Y-X.....	5,00€
• Pikat Poligonale:	
• Koordinatat Y-X-Z	3.00€
• Pikat e detajit:	
• Koordinatat Y - X.....	1.00€
• Pikat lidhëse:	

- koordinatat Y-X3.00€
- Koordinata Y-X-Z.....5.00€
- Pikat Linjë
- Koordinatat Y-X-Z.....2.00€
- Vendosija e pikave trigonometrike50.00€
- Për zbatimin e nenit 10 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi.

Neni 11

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

11.1 Bazuar në udhëzimin administrativ nr.41- 2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, propozohen këto taksa:

- Për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore :
 - a.) Klasa e I – IV do të jetë1 € për metër katror
 - b.) Klasa e V – VI kompensimi do të jetë0,75 € për metër katror
 - c.) Klasa e VII – VIII kompensimi do të jetë0,50 për metër katror

11.2 Rregullorja Komunal për taksat, ngarkesat dhe gjambat komunale nga lëmi i bujqësisë caktohen këto taksa:

- Vërtetim për shitjen e prodhimeve bujqësore është..... 10 €
- Vërtetim që merret me veprimtari bujqësore është..... 10 €
- Vërtetim që merret me veprimtari bujqësore grat fermerepa pagese
- Taksa për peshkim brenda kufijve të Komunës do të caktohet me vendim të veçanët të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Për zbatimin e nenit 11 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 12

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

12.1.1 Leje për vendosjen e transmetuesve (antenave), me frekuenca të ndryshme për nevoja të telefonisë mobile, fikse, televizionit dhe tjera të ngjashme paguhen tarifa vjetore sipas zonave:

- a) Zona e I 600.00 €/vit
- b) Zona e II 450.00 €/vit
- c) Zona e III 400.00 €/vit
- d) Zona e IV 300.00 €/vit

12.1.2 Ndërsa vendosja në pronë private paguan 50% të shumës.

12.1.3 Shfrytëzimi i hapësirave publike për ekspozimin e prodhimeve pranë lokaleve jo ushqimore 2 €/m²/muaj.

12.1.4 Shfrytëzimi i hapësirave publike pranë ndërtesave për aktivitete biznesi për rehatinë e klientëve, (kafiteritë, restorantet) 2 €/m²/muaj.

12.1.5 Shfrytëzimi i hapësirës publike për shfaqje të ndryshme (zbavitje, manifestime) para shtëpisë së Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” në Viti të cilat nuk janë të organizuara nga Komuna e Viti-së 30 €/ditë

12.1.6 Furnizim me ujë për pastrim, një cistern20 €

12.1.7 Për raste sociale, familje të dëshmorëve, invalidët, invalidët e luftës, për persona me aftësi të kufizuara dhe veteran të luftës, furnizimi me ujë bëhet falas.

12.1.8 Qiradhënia e banesave, shitoreve dhe ndërtesave publike apo një pjesë e tyre do të jepet me ankand ose Koncesion personit që prezanton ofertën më të lartë.

Komuna mundë të vendosë që rasteve sociale ti jepet me qira banesat me çmim të subvencionuar.

Në këtë rast kriteret duhet të vendosin që ti japin prioritet njerëzve që kanë më shumë nevojë.

Neni 13

13.1 Komuna që ka hapësira publike për parkimin publik të automjeteve të jepen në shfrytëzim përmes ankandit publik.

Për automjetet që shfrytëzojnë hapësira përkatëse, parkim, taksa do të paguhet sipas zonave për parkim të automjetit siç vijon:

13.1.1 Si Zonë të parë konsiderojmë rrugët “Adem Jashari”, “Xhemajl Ademi” dhe “28 Nëntori”, kurse rrugët tjera si zonë e dytë.

- a) Zona I.....0.30 €/orë
- b) Zonat tjera.....0.20 €/orë

13.1.2 Për kamioneta deri 3.5t dhe kamionë mbi 3.5t në zonën e parë nuk lejohet parkingu, kurse në zonat tjera0.50 €/orë.

13.1.3 Për taksi individual:

- a) Zona e I është.....50 € /vit
- b) Zonat tjera.....30 €/vit

13.1.4 Për operator taksi (deri në pesë (5) automjete

- a) Zona e I është.....150 €/vit
- b) Zonat tjera.....100 €/vit

Për operator taksi (prej 6 deri 10 automjete)

- a) Zona e I është.....250 €/vit
- b) Zonat tjera.....150 €/vit

Mbi 10 automjete

- a) Zona e I është.....300 €/vit
- b) Zonat tjera.....200 €/vit

13.1.5 Për automjetet që shfrytëzojnë hapësira përkatëse parkimi të rezervuar publik:

- a) Për persona juridik.....25 €/muaj
- b) Për persona fizik(baneret në banim kolektiv – banesat).....8 €/muaj
- c)Për automjetin e kryqit të kuq lirohen nga pagesa për parkim të rezervuar publik.

13.2 Lejet që duhet të lëshohen nga Sektori i Trafikut dhe Transportit

13.2.1 Leje e punës për auto-taxi individual është..... 20 €

13.2.2 Leja e punës për kompani auto-taxi është..... 60 €

13.2.3 Leja e punës për kompani të autobusëve është..... 90 €

13.2.4 Leje punës për transport të veçantë..... 20 €

13.2.5 Ndryshimi i të dhënave të automjeteve për leje pune është.....5 €

13.2.6 Leje e përkohshme për hyrje dalje në rrugë përkatëse.....5 €/muaj

13.2.7 Leje e përkohshme për shkarkimin e mallit para shitoreve për automjete deri në 1.5t është.....1 €/orë

13.2.8 Leje për një (1) hyrje në qytet të automjetit transportues për mallra komerciale (tregtare) mbi 3.5 ton në terminin e kohës:

- a) për sezonin verorë nga ora 10:00 deri ora 20:0015 €

13.2.9 Leje për hyrje në qytet të automjetit transportues mbi 3.5 ton për transportimin e materialit (largimi i dheut, betonit dhe materialeve tjera ndërtimore):

- a) për një hyrje 10€
- b) për dy hyrje nga 6 €
- c) për tri hyrje nga 5 €
- d) për katër e më shumë hyrje nga 4 €

13.2.10. Leje e përkohshme për shkarkimin e mallit para shitoreve

Për automjete deri në 3.5t..... 2 €/orë

13.2.11 Leje e përkohshme për punimet në rrugë (bllokimi i rrugës) 4 €/orë

13.2.12 Vërtetimi i rendit të udhëtimit për transportuesit e udhëtarëve:

a) për autobus është 30 €/vit

b) për automjete (9-17 ulëse) 15 €/vit

13.3 Shfrytëzimi dhe kompensimi i dëmtimeve në hapësirat publike.

13.3.1 Vendosija e reklamave në pronë publike.

13.3.2 Vendosija e reklamave, postareve në qytet..... 25 €/m²/vit, 3 €/m²/muaj.

13.3.3 Për reklama me ndriçim 50 €/m²/vit, 6 €/m²/muaj.

13.3.4 Nëse pllakati është shumë krahësh, paguhet për çdo krah të dukshëm.

13.3.5 Vendosija e reklamave në pronë private paguan 50% më lire.

13.3.6 Vendosija e reklamave në muret e objekteve private nuk paguan fare.

13.3.7 Vendosija e reklamave në fasada – muret e ndërtesave publike ... 25 €/m²/vit, 3€/m²/muaj.

13.3.8 Vendosija e ekraneve elektronike reklamuese 80 €/ m²/vit, 8€/m²/muaj.

13.3.9 Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet më pak se 30 ditë shtohet vlera për ... 100 %.

13.3.10 Pagesa e taksave komunale për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendosjen e reklamave do të bëhet sipas zonave me përqindje, duke u bazuar në nenin 13.3 pika 1-7, që është zonë e parë me 100%.

a) Zona e I.....100%

b) Zona e II.....75%

c) Zona e III.....50%

d) Zona e IV.....25%

13.3.11 Shfrytëzimi i hapësirave publike për kioska (objekte lëvizëse)

Në zonë të parë janë caktuar rrugët “Adem Jashari”, “Xhemajl Ademi”, dhe “28

Nëntori”

a) Zona e I 50 €/m²/vit 5 €/m²/muaj

b) Zona e II (të gjitha rrugët tjera të qytetit).....25 €/m²/vit, 3 €/m²/muaj

c) Zona e III (nëpër fshatra)..... 10 €/m²/vit, 1 €/m²/muaj

13.3.12 Pagesa e taksës për ndërhyrje në infrastrukturë komunale:

a) Personi që pajiset me leje për dëmtimin e asfaltit për kyçje në ujësjellës dhe kanalizim.

Për persona Jurdik.....80€/ m²

Për persona Fizik50€/m²

b) Dëmtimi i rrugës së pa asfaltuar, parqeve, kubave të betonit, beton etj:

Për persona Jurdik.....40€/m²

Për persona Fizik.....20€/ m²

c) Leje për ndërhyrje në infrastrukture pa prerje të asfaltit (me shpim):

Për persona Jurdik.....4€/ m, gjatësi

Për persona Fizik.....3€/ m, gjatësi

Për pikën a,b dhe c personi është i obliguar ta kthej deri në gjendjen e mëparshme, asfaltit - asfaltin e shtron komuna.

13.3.13 Tarifat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike sipas zonave të qytetit për m². Vendosija e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla, të përkohshme – sezonale në të cilat kryhet veprimtaria (tregti, hotelieri), si dhe pajisje të caktuara teknike (gjenerator, bankomat), tarifa mujore

a) Zona e I 6 €/m²/muaj, 0.40 €/m²/ditë

b) Zona e II 4 €/m²/muaj, 0.30 €/m²/ditë

c) vendosja e tezgave nga shoqatat e grave për shitjen e produkteve bujqësore lirohen nga pagesa.

13.3.14 Vendosija e mjeteve për akullore, aparat për kafe dhe mjete tjera – tarifa mujore:

a) Zona e I.....6 €/m²/muaj, 0.50 €/m²/ditë

b) Zona e II.....4 €/m²/muaj, 0.40 €/m²/ditë

13.3.15 Leje për shfrytëzimin e pronës komunale, për vendosjen e stabilimenteve të ndryshme nga ana e operatorëve të ndryshëm si Kompania Kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike SHA, Vala Kosova telekom , Telekomunikacion LLC (aktivitetet e telekomunikimit kabllor primare) e të tjerë, aplikohen taksa sipas zonave:

a) Zona e I.....	1 €/m ² /muaj
b) Zona e II.....	0.75 €/m ² /muaj
c) Zona e III.....	0.50 €/m ² /muaj
d) Zona e IV.....	0.30 €/m ² /muaj

13.3.16 Tarifat për organizimin e lojërave argëtuese, të fatit dhe lojërave argëtuese automatike të ndryshme, si dhe rekuizitave tjera sportive.

a) Vendosja e aparateve për lojëra fati, lojëra argëtuese etj. Tarifa mujore për çdo aparat sipas llojit	8 €/m ² / muaj
b) Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese). Tarifa mujore për m ²	0.50 €/muaj
c) b) Shfrytëzimi I hapësirës private për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese). Tarifa mujore për m ²	0.30 €/m ² /muaj
d) Leja për vendosjen e materialit ndërtimor, druve, thëngjillit etj. Në hapësirat publike për 24 orë.....	10 €
e) Shtrirja e rrjetit kabllor (nëntokësorë, ajror) të internetit, telefonik, elektrik, telekomunikacionit dhe TV. për metër gjatësi.....	0.40 €
f) Vendosja e ormanëve shpërndarës MDF-së, për copë – tarifa mujore	10 €/muaj
g) Vendosja e foltoreve telefonike – tarifa mujore	8 €/muaj
h) Pëlqimi për rregullimin e trotuarit	10 €

13.4 Marrja e lejes për kycjen e infrastrukturës

Për marrjen e lejes për kycje në rrjetin e infrastrukturës komunale në ujësjellës, kanalizime paguhet taksat:

13.4.1 Për objekte individuale.....	30€
13.4.2 Për objekte kolektive	100€
13.4.3 Për objekte afariste-ekonomike industriale.....	50€
13.4.4 Për objekte të përkohshme montuese	20€

13.5 Tregu i gjelbër dhe tregu i kafshëve

13.5.1 Tregu i gjelbër dhe tregu i kafshëve, menaxhimi i tyre do të vendoset sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

13.5.2 Mirëmbajtja e pastërtisë së hapësirave publike komunale do të realizohet sipas tenderit publik.

13.6 Taksa komunale për ushtrimin e biznesit për kompanitë e taksistëve dhe taksitë individual.

13.6.1 Kompanitë e transportit.....	120 €/vit
13.6.2 Operatori i Taksive.....	105 €/vit
13.6.3 Taksistët individual.....	35 €/vit

13.7 Taksat Komunale për shërbimin e mbeturinave komunale

13.7.1. Bartja e mbeturinave – amvisnitë.....	5.00€
13.7.2. Kiosqet, argjendaritë, fotografët, avokatët etj.....	8.00€
13.7.3. Serviset, butikët, këmbimoret etj.....	6.00€
13.7.4. Furrat, ordinancat, shitoret ushqimore etj.....	13.00€
13.7.5. Shitoret ushqimore, shitore e tekstitit etj, (zona 2).....	10.50€
13.7.6. Restorantet, podrumet e pijeve etj (zona1).....	22.00€
13.7.7. Pompat e benzinës, restorantet eyj. (zona2).....	19.50€
13.7.8. Depo e materiali ushqimor, supermarket etj.....	28.00€
13.7.9. Mishtoret, kooperativat bujqësore etj.....	22.00€
13.7.10. Kontejneri 1.1m ³	12.00€

13.7.11. Kontejneri 4.5m3.....31.50€

Nga pagesa e tarifave të nenit 13.7 lirohen rastet sociale, familja e ngushtë e dëshmoreve, invalidët e UÇK -se dhe veteranet e UÇK -se.

Neni 14

14. Taksat Komunale për bartjen e automjeteve nga trafiku – “Shërbimet e transportit me marimang”.

14.1 Zhvendosja e motoçikletës, veturës te traktorit pa rimorkio, brenda qytetit, deri ne vendin për vendosje dhe ruajtja e tyre deri ne 24 ore.....30,00€

14.2 Tërheqja e autobusit, mjetit transportues, rimorkios ose gjysmë rimorkios brenda qytetit deri ne vendin për vendosje dhe ruajtjen e tyre deri ne 24 ore100,00€

14.3 Zhvendosja e automjeteve nga jashtë qytetit pa ngarkese është 0,25€ për 1 km, ndërsa me ngarkese 0,50€.

14.4 Ne rastin kur zhvendosja e automjetit vetëm fillon, por nuk behet zhvendosja deri ne vendin e ruajtjes zbatohen çmimi si vijon: ne zonën urbane 15,00€, ndërsa jashtë zonës urbane 30,00€.

14.5 Kur automjeti i zhvendosur, pas kalimit te kohës prej 24 ore nuk merret nga pronari ose shfrytëzuesi siç përcaktohet ne rregullore për çdo dite të ruajtjes ose qëndrimit të mëtutjeshëm te automjetit do te paguhet çmimi prej 5,00€ për çdo ditë.

14.6 Për zhblokimin e automjeteve, autobusëve, mjeteve transportuese, mjeteve te punës dhe rimorkiove, do të paguhet çmimi pre 15,00€.

14.7 Nëse për automjetin e bllokuar, pas kalimit te kohës prej 24 orëve, pronari ose shfrytëzuesi i automjetit nuk i përmbush detyrimet siç i përcakton rregullorja për zhblokimin e automjetit, ruajta përkatësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i mjetit nen bllokim për çdo dite qëndrimi dhe ruajtje do te paguhet çmimi prej 5,00€.

Neni 15

15 Taksa komunale për leje (posedim) të automjeteve.

15.1 Të gjithë pronarët- poseduesit e automjeteve motorike, duhet të paguajnë:

a) Për automjete dhe taxi-automjete:

Benzinë – naftë:

Deri 3500 cm.....10 €

Mbi 3500 ccm.....20 €

b) Për kamionë që bëjnë transportin e mallrave:

Benzinë – naftë:

Deri në 3.5t.....10 €

Mbi 3.5t.....20 €

c)Për autobus.....20 €

Nga taksat komunale për regjistrimin e automjeteve lirohen familjet e dëshmorëve dhe te zhdukurit e UÇK-se dhe invalidëve te UÇK-së.

Neni 16

16.1 Komuna i ngarkon me taksa subjektet afariste dhe personat fizik të cilët janë pronarë të automjeteve. Në rast të mos pagesës së taksës për lejim (posedim) të veturave dënimi do të jetë sa pesë herë vlera e taksës.

16.2- Komuna e Vitisë zonat i ka të ndara në dy niveleve:

Qyteti I Vitisë ndahet në tri zona;

Fshatrat e Komunës së Vitisë ndahet në katër zona.

16.3-Qyteti i Vitisë për ngarkesë për taksa ndahet në tri zona;

Zona e I (parë): përfshinë zonën qendrore dhe të gjitha parcelat frontale të zonave tjera që kufizohen me këtë zonë.

Zona e II (Dytë): Përfshinë zonën industrial, parcelat frontale që kanë qasje në rrugën “Muhamet Muharremi” deri në përfundim të zonës deri në përfundim të zonës kadastrale të Qytetit të Vitisë, parcelat frontale që kanë qasje në rrugën “Hoxhë Januzi” nga rrethi duke vazhduar me rrugën “Rexhep Bislimi” deri te zona industrial.

Zona e III (tretë): përfshinë Zona Veriore Perëndimorë, Zonën Jugore dhe Zonën Lindore, përpos parcelave të cilat përfshihen në zonën e I (parë) dhe të 2 (dytë).

16.4 Fshatrat e Komunës së Vitisë për ngarkesë për taksa ndahen në katër zona:

Zona e I (parë): përfshinë parcelat frontale të cilat kanë qasje në rrugën Gjilan- Ferizaj nga fillimi I territorit të Komunës së Vitisë (fsh. Budrikë e Epërme) deri në përfundim të territorit të komunës së Vitisë (fsh.Ramjan), si dhe parcelat frontale që kanë qasje në rrugën Viti-Gërlicë, nga fillimi I fshatit Drobesh e deri në përfundim të kufirit Komunale të Vitisë (fsh. Sodovinë e Çerkezve).

Zona e II (dytë): përfshinë zonat kadastrale: Pozharan, Drobesh, Kabash, Ramnishtë, Radivojcë, Letnicë, Budrikë e Epërme, Ramjan Gërmovë, Sadovin e Jelive.

Zona e III (tretë): përfshinë zonat kadastrale : Smirë, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Ultë, Tërpezë, Gjylekarë Binçë, Begunca, Vërbanë, Goshicë, Zhiti, Sodovinë e Çerkezve, Trestenik, Novosellë, Çifllakë ,Potgorc, Shashare, Lubishtë Buzuvik, Stubllë e Epërme dhe Remnik.

Zona e IV(katërt) përfshin zonat Kadastrale; Stubëll e Ultë Goden, Vërnez, Vërnakollë, Debëlldeh , Mjak, Ballancë, Devajë.

Neni 17

17.1 Automjetet e intervencës, automjetet e kryqit të kuq, automjetet speciale të mbrojtjes shëndetësore, automjetet e zjarrfikësve dhe automjetet e ndërmarrjeve publike (automjetet për transportin e të vdekurve, mjetet motorike për pastrimin e kanalizimeve dhe lumenjve, automjetet për bartjen e mbeturinave, mjetet motorike për transportin e fekaleve, mjetet motorike për bartjen e kafshëve të ngordhura etj) nuk i nënshtrohen pagesës së taksës nga neni 15 i këtij vendimi.

17.2 Nga pagesa e tarifave 13.2.11 dhe 13.3.12 pikat a),b),c), lirohen kompanitë të cilat i realizojnë projektet e kontraktuara me Komunën gjatë ndërhyrjes në infrastrukturën publike si dhe ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbime publike (PTK, KEDS, Hidrморava, Ekohigjena, Stacioni i Autobusëve dhe Shërbimet Emergjente), me kusht që dëmtimet të infrastrukturës publike të kthehen në gjendjen e mëparshëm, menjëherë pas kryerjes së punimeve dhe mbikëqyrjen për kthimin në gjendjen e mëparshme të infrastrukturës së dëmtuar Komunale e benë një komision i përbashkët nga DSHPE dhe Drejtoria e Inspektoriatit.

Neni 18

18.1 Nga ngarkesa për leje për automjeteve motorike lirohen familja e ngushtë e dëshmoreve, invalidët e luftës dhe personat me aftësi të kufizuar sipas nenit 15.

Neni 19

19.1 Automjetet dhe mekanizmi bujqësor nuk i nënshtrohen pagesës së taksave komunale për automjete.

19.2 Taksat dhe pagesat e tjera nga inspektori i preventives kundër zjarrit do të realizohen sipas vendimit të veçantë të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Për zbatimin e neneve 12,13,14,15,16,17,18 dhe 19 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 20

DREJTORIA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

Me ligjin për tregti të brendshme të aprovuar në qershor 2011 nuk ka leje pune.

Neni 21

Ngarkesat caktohen për bizneset që zhvillojnë biznes apo veprimtari afariste brenda territorit të Komunës së Vitisë dhe do të paguhet në baza vjetore sipas llojit të veprimtarisë, sipas kategorive të poshtë shënuara:

21.1.1. Super market -Hipermarket 101m ² -200m ²	200€
21.1.2 Minimarketet prej51m ² -100m ²	140€

21.1.3	Shitore ushqimore dhe të tekstilit deri në 50m2.....	80€
21.1.4	Libraritë.....	80€
21.1.5	Depot e mallrave Ushqimore.....	200€
21.1.6	Podrumet e piqeve.....	120€
21.1.7	Barnatoret Shëndetësore.....	120€
21.1.8	Barnatoret Bujqësore.....	100€
21.1.9	Shitore e këpucëve dhe çantave.....	100€
21.1.10	Shitore e autopjesëve dhe autogomave.....	100€
21.1.11	Shitore e mobileve.....	100€
21.1.12	Sallonet e mobileve.....	200€
21.1.13	Shitore e tepihëve.....	100€
21.1.14	Shitore e ngjyrave dhe llaqeve.....	100€
21.1.15	Shitore e llaminatit, dyerve prej drurit.....	120€
21.1.16	Shitore e pllakave të qeramikës dhe pjesëve te ujit.....	100€
21.1.17	Shitore e veglave muzikore.....	80€
21.1.18	Shitore e teknikes se bardhe dhe hekurishtet.....	100
21.1.19	Shitore e farërave, leblebive (faragjinjë).....	40€
21.1.20	Shitore optike kozmetike, bizhuteri dhe lulishtet.....	100€
21.1.21	Shitore kurorave dhe funeraleve.....	50
21.1.22	Shitore e vezëve.....	50€
21.1.23	Shitore e tonerëve për teknik informative.....	100€
21.1.24	Tregtia me pakicë e mjeteve medicinale dhe ortopedike.....	100€
21.1.25	Tregtia me pakicë e aparateve të përdorura, te importuara.....	120€
21.1.26	Tregtarët lëvizës (kioskat).....	30€
21.1.27	Sallonet e veturave.....	200€
21.1.28	Mobil Shpet.....	50€
21.1.29	Depot e materialit ndërtimor.....	200€
21.1.30	Parkingjet private.....	80€
21.1.31	Tregti me pakice e artikujve te imte te përzier (1.25€).....	50€
21.1.32	Veprimtaritë e shtypshkronjës.....	100€
21.1.33	Veprimtaritë e pylltarisë.....	100€
21.1.34	Veprimtari për fotografimin e dhëmbëve.....	100€
21.1.35	Veprimtari çerdhe e femijeve.....	150€
21.1.36	Autolarjet grupi i parë.....	50€
21.1.37	Autolarjet grupi i dytë.....	30€
21.1.38	Vullkanizerët grupi i parë.....	70€
21.1.39	Vullkanizerët grupi i dytë.....	50€
21.1.40	Bukëpjekësit grupi i pagë.....	70€
21.1.41	Bukëpjekësit grupi i Dytë.....	50€
21.1.42	Artizanatet.....	30€
21.2. Punëtoritë		
21.2.1	Internet-Kafe.....	70€
21.2.2	Shpërndarësit e rrjetit te internetit.....	100€
21.2.2	Argjendarët.....	100€
21.2.3	Zdrukthëtarët grupi I.....	130€
21.2.4	Zdrukthëtarët grup II.....	100€
21.2.5	Automekaniket grupi i I.....	100€
21.2.6	Automekaniket grupi i II.....	60€
21.2.7	Metal punuesit.....	80€
21.2.8	Metal gdhendës (drebant).....	70€

21.2.9	Varrezat e metaleve dhe rikuperues të mbeturinave	100€
21.2.10	Shpuesit e puseve	200€
21.2.11	Fotografet.....	100€
21.2.12	Floktaret individual për meshkuj(berber).....	50€
21.2.13	Floktaret për femra(frizeret).....	80€
21.2.14	Sallonet e ondulimi.....	80€
21.2.15	Orëtarët.....	20€
21.2.16	Rrobaqepësit	40€
21.2.17	Rrobaqepës prodhues.....	100€
21.2.18	Këpucëtar(riparim i këpucëve).....	20€
21.2.19	Teneqepunuesit.....	70€
21.2.20	Autoelektricitët	50€
21.2.21	Elektroservisët	50€
21.2.22	Servisët e frigoriferëve.....	70€
21.2.23	Xhampresit.....	70€
21.2.24	Butikët.....	70€
21.2.25	Punuesit e mbishkrimeve te firmave.....	70€
21.2.26	Punuesit dhe montuesit te roletave	80€
21.2.27	Fushat sportive te mbyllura.....	80€
21.2.28	Fusha sportive te hapura.....	50€
21.2.29	Moler – gipser suvatues	150€
21.2.30	Instalues i rrymës, ujit.....	50€
21.2.31	Kafebluarsit.....	30€
21.2.32	Riparim i aparateve për zjarrfikës.....	80€
21.2.33	Riparim i gjeneratorëve dhe sharrave.....	70€
21.2.34	Riparim dhe servisim i biçikletave.....	30€
21.2.35	Veprimtari që merren me pastrimin e objekteve.....	100€
21.2.36	Riparim i teknologjisë informative, jo shitje.....	80€
21.2.37	Tregtia me pakice e pajisjeve sanitare.....	150€
21.2.38	Veprimtaritë profesionale.	
21.2.39	Avokatët.....	100€
21.2.40	Agjencionet e udhëtimeve.....	70€
21.2.41	Noterët.....	200€
21.2.42	Zyra të kontabilitetit.....	50€
21.2.43	Byrot projektuese.....	120€
21.2.44	Organizimi i kurseve të ndryshme.....	50€
21.2.45	Stomatologët.....	120€
21.2.46	Stomatologët me orar të kufizuar te punës.....	60€
21.2.47	Ordinancat mjekësore.....	100€
21.2.48	Ordinancat mjekësore me orar të kufizuar.....	50€
21.2.49	Ordinancat veterinare.....	100€
21.2.50	Zyra për përkthime (përkthyesit).....	60€
21.2.51	Gjeometrat dhe arkitektet.....	100€
21.2.52	Autoshkollat	70€
21.2.53	Organizues të lojërave te fatit.....	200€
21.2.54	Agjencitë e sigurimit te automjeteve.....	200€
21.2.55	Agjencitë për transfer te parave.....	150€
21.2.56	Pompat e benzinës, naftës dhe gazit grupi i parë.....	250€
21.2.57	Pompat e benzenë naftës dhe gazit grupi i dytë.....	190€
21.2.58	Pompat e benzinës naftës dhe gasit grupi i tretë.....	150€

21.2.59	Kontrollimi teknik i automjeteve.....	150€
21.2.60	Agjencioni i shpëtimit dhe auto-tregjeve.....	150€
21.2.61	Televizioni privat	200€
21.2.62	Radiot privat.....	100€
21.2.63	Lotaria	400€
21.2.64	Bastoret sportive.....	200€
21.2.65	Shumëzues të kasetave dhe videove.....	50€
21.2.66	Telekomunikimet dhe shpërndarësit e rrjetit kabllokovik.....	200€
21.2.67	Tregtia me pakice e aparateve elektrike, radiove dhe aparate te TV.....	150€
21.3	Shërbimet ushqimore	
21.3.1	Kafiteritë	105€
21.3.2	Restorantet	125€
21.3.3	Motelet	155€
21.3.4	Hotele	280€
21.3.5	Ëmbëltoret.....	105€
21.3.6	Qebaporet	80€
21.3.7	Mishtoret (thertoret).....	80€
21.4	Shërbimet financiare	
20.4.1	Bankat ekspoziturat.....	500€
20.4.2	P.T.K.-Komunikim dhe distribucion.....	500€
20.4.3	K.E.K.-Njësit punuese.....	350€
20.4.4	Këmbimore	200€
21.5	Ndërmarrjet Ndërtimore	
21.5.1	Ndërmarrjet ndërtimore grupi I.....	200€
21.5.1	Ndërmarrjet ndërtimore grupi II (nëpër fshatra).....	150€
21.5.2	Gurthyesit	200€
21.5.3	Mullinj të elektrik.....	150€
21.5.4	Fabrikat për përpunimin e ujit.....	250€
21.6.1	Për çdo subjekt afarist që shfrytëzon më tepër se një objekt aktiviteti ekonomik do të	paguaj për secilin
	njësi afariste ne shumë prej 30% te ngasëses bazë.	
21.6.2	Për subjektet qe nuk janë në rrugë kryesore qe zhvillojnë biznes tregtar ushqimor dhe atë nëpër fshatra do të paguajnë 50% taksë komunale.	

Neni 22

Kuvendi Komunal i Vitisë, me miratimin e kësaj propozim rregullore, do t'i pezullon nenet 21, 41 dhe neni 13, pika 13.6 të kësaj propozim rregullore për periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2020, për pagesën e taksave komunale për subjektet afariste.

Neni 23

Obligimi i pagesës së ngarkesës komunale nga biznesi duhet të përmbushte ndaj Kuvendit të Komunës deri 31.12. të vitit fiskal.

Bizneset mund ti kryejnë obligimet e ngarkesës komunale në dy këste: kësti i parë deri më 30.06 të vitit përkatës dhe kësti i dytë deri më 31.12 të vitit për të cilin ekziston obligimi.

Çdo vonesë e pagesës së taksës pas datës 31.01 të vitit vijues do të ndëshkohet me 1% kamatë për çdo muaj vonesë e cila kamat mund te llogaritet me se shumti për 12 muaj .

Mospërfillja e pagesës së taksave së paku pas dy vërejtjeve do të rezultojë me ndërprerjen e përkohshme të veprimtarisë , do të iniciohen procedurë për kundërvajtje pran Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Viti, dhe të njëjtit do të gjobiten në shumë prej:

Grupi i parë..... 100-150€
 Grupi i dytë..... 50 – 100€
 Për zbatimin e neneve 20, 21, 22 dhe 23 do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 24

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Të hyrat nga Shëndetësia janë të hyra nga bashkëpagesat të cilat realizohen në pajtim me udhëzimin administrative 04/2007 dhe 04/2011 të Ministrisë së Shëndetësisë.

Shtojca 1-a

Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor.

Nr.	Lloji i shërbimit	€
1	Ekzaminimi mjekësor në punkt. QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1,00
2	Ekzaminimi specialistik në QMF-QKMF me udhëzim të mjekut të familjes	2,00
3	Ekzaminimi specialistik në QMF-QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes	4,00
4	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në raste emergjente	6,00
5	Medikamenti nga Lista esenciale, ofruar në barnatoren publike	0,30
6	Ultrazëri standard	2,00
7	Radiografia çdo ekspozim (film)	2,00
8	EKG	0,50
9	Analiza laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina	1,00
10	Analizat laboratorike (komplet)	3,00
11	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1,00
12	Audiograma	1,00
13	Shpëlarja e veshit	1,00
14	Dhënia e inekcionit intermuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente	1,00
15	Dhënia e inekcionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente	1,00
16	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrim deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	3,00
17	Trajtimi ditor me infuzion në institucione shëndetësore	1,00
18	Çertifikata shëndetësore për punësim	15,00
19	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5,00
20	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj. për 1 orë	25,00

Shtojca 2-a

Çmimorja e bashkë pagesave për shërbimet stomatologjike të nivelit parësor të QKMF-së dhe QMF

Nr.	Lloji i shërbimit	€
1	Vizitë e parë stomatologjike	1,00

2	RTG i dhëmbit	1,50
3	Mbushja e përhershme me amalgam	4,00
4	Mbushje e përhershme me kompozitë	5,00
5	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozit)	5,00
6	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozit)	6,00
7	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozit)	6,00
8	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozit)	6,00
9	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozit)	6,00
10	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozit)	6,00
11	Rindertimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6,00
12	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1,00
13	Flourizimi i dhëmbëve sipas seancave	1,00
14	Vulosja e fisurave	1,00
15	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1,00
16	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëve të dhëmbëve me ultra tingull)	3,00
17	Kiretazha e gjepave parodontal (një dhëmbë)	1,00
18	Nxjerrja e dhëmbit	1,50
19	Incizioni infra dhe extra oral	1,50
20	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1,00
21	Riparimi i protezës (ngjitja)	1,50

24.1 Grupet e popullatës të liruara nga bashkëpagesat e shërbimeve shëndetësore nga neni 24 bëhet në bazë të nenit 61 të Ligjit për Shëndetësi nr.04/L-125.

24.2 Personat me Aftësi të Kufizuara që posedojnë dëshmitë, lirohen nga pagesat sipas Strategjisë Nacionale dhe Lokale për PAK-të, Gratë kryefamiljare, viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikut njerëzor.

24.3 Në rast të ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore si dhe udhëzimit administrativ, si dhe zbrazëtirës juridike të rregullores, sa i përket tarifave, taksave dhe bashkëpagesave të kësaj lëmie, vlejnë drejtpërdrejt dispozitat pozitive.

24.4 Çmimet për shërbimet shëndetësore të ofruara sipas Nenet 24 për shtetasit e huaj dhe bartës të sigurimeve të huaja do të jetë pesë (5) herë më të larta se sa çmimi aktual i bashkëpagesës për banoret e Kosovës, kjo pagesë nuk vlejnë për bashkatdhetarët tanë që jetojnë në shtetet e jashtme.

Neni 25

25.1 Llojet dhe lartësia e taksave nga Shërbimet e Qendrës për Punë Sociale:

25.1.1	Vërtetim për lirim nga Shtetësia e Republikës së Kosovës.....	10.00 €
25.1.2	Vërtetim për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës	10.00 €
25.1.3	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe veprimi	3.00 €
25.1.4	Pëlqim për martesë para moshës madhore	5.00€
25.1.5	Vërtetim që nuk është shfrytëzues i ndihmës sociale	3.00€

25.1.6 Caktimi i emrit personal.....	3.00€
25.1.7 Kërkesa për regjistrim të mëvonshëm	5.00€
25.1.8 Pëlqim për përfaqësim në Gjykatë për fëmijët për trashëgimi, nënshkrim të kontratave të ndryshme.....	5.00€
25.1.9 Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijët	5.00€
25.1.10 Pëlqim për bashkim familjar me prindin ose prindërit e tyre që jetojnë jashtë vendit	5.00€
25.1.11 Vërtetim që nuk merr ndihma (shtesa për fëmijë).....	10.00€
25.1.12 Pëlqim për dokumente të udhëtimit	5.00€
25.1.13 Vërtetime të ndryshme të lëshuara nga drejtoria e shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	3.00€
25.1.14 Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit (Armë).....	10,00€

25.2 Nga pagesat për shërbimet e kryera komunale sipas nenit 25. lirohen:

a) Shfrytëzuesit e ndihmës sociale, Invalidët e luftës, familjet e Dëshmorëve, Veteranët e luftës dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushta, personat me aftësi të kufizuar, viktimat e luftës dhe familjet e tyre të ngushta.

Për zbatimin e nenit 24 dhe 25 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 26

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

26.1. Subjektet e biznesit duhet të paguajnë taksë administrative për pranimin teknik të lokalit nga organi i inspeksionit për vendimet mbi plotësimin e kushteve minimale higjieno-sanitaro-teknike dhe atë:

26.1 Për Kioska paguhet taksa në shumë prej	12€.
26.2 Për lokalet deri në 50m ²	25€
26.3 Për lokalet prej 51 deri në 100m ²	35€.
26.4 Për lokalet prej 101 deri në 150m ²	50€.
26.5 Për lokalet prej 151 deri në 200m ²	70€.
26.6 Për lokalet prej 201 deri në 300m ²	100€
26.7 Për lokalet prej 301 deri në 400m ²	150€
26.8 Për lokalet prej 401 deri në 500 m ²	200€
26.9 Për lokalet që posedojnë hapësirë mbi 500m ² paguhet shtesë për çdo metër katror në shumë prej 0,35€.	
26.10 Subjektet afariste paguajnë 50% të taksës të cilat më parë ishin të regjistruara:	
▪ Në raste të ndërrimit të pronarit të biznesit, ku zhvillohet veprimtaria në të	
▪ njëjtin lokal.	
▪ Në rast të ndërrimit të emrit të biznesit,	
▪ Në rast se dështon në plotësimin e kushteve të parapara nga komisioni për pranim teknik të lokalit, për herën e parë dhe konform rregullores obligohet ta përsërit kërkesën komisionit për pranim teknik të lokalit.	
▪ Në rast të ndryshimit të veprimtarisë në lokalit e njëjte, ku ka operuar me vendim të më hershem.	
26.11. Taksa për pëlqime sanitare për barnatore shëndetësore	20,00€
26.12. Taksa për pëlqime fitosanitare për barnatore bujqësore	20,00€
26.13. Procesverbali mbi shikimin e automjetit	10,00€
26.14. Leje për transport të veçantë	10,00€
26.15. Leje qarkullimi në rrugë të ndaluar për atë lloj automjeti.....	10,00€
26.16. Përçim për garazh dhe kyçje	20,00€
26.17. Leshimi i certifikatave të transporti të kafshëve të gjalla brenda territorit të Kosovës 20% e shumës brenda vitit e akumuluar nga AVU kthehen në buxhetin Komunal.	
26.18. Taksa për kontrollimin e mishit për krerë.....	5,00€

Për zbatimin e nenit 26 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për Inspeksion.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MJEDIS

27.1 Llogaritja e lartësisë së pagesës së kontributeve për rregullimin e tokës ndërtimore do të bëhet nga ana e drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe mbrojtje të mjedisit në bazë të dokumentacionit teknik të parashtruar këtij organi nga ana e investitorit dhe llogaritet për m²

Të sipërfaqes (neto shfrytëzuese) për ndërtim.

27.2 Objektet arsimore, kulturore, sportive, shëndetësore, si dhe qendrat rekreative, që ndërtohen me mjete buxhetore, me investime të komunitetit apo me donacione dhe janë të interesit të përgjithshëm, janë të liruar nga pagesa e kontributeve të parapara me këtë rregullore, për shkak të destinimit të tyre.

Kompensimi nuk paguhet në këto raste:

- Për sipërfaqet ku bëhet deponimi i plehrave – mbeturinave,
- Për varrezat,
- Për sipërfaqet e parkingut publik,
- Për sipërfaqet e gjelbërimit publik,
- Për sheshet (publike), dhe
- Për rrugët (publike).

27.3 Kompensimi për rregullimin dhe shfrytëzimin e tokës ndërtimore

Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore, në bazë të kësaj rregulloreje paraqet shpenzimet mesatare të rregullimit të marra në bazë të llogarisë mesatare të ndërtimit të objekteve të infrastrukturës dhe përshtatshmërisë të cilën lokacioni e ka.

Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore bëhet me rastin e ndërtimit të objektit, zgjerimit të objektit ekzistues, mbindërtimit, shndërrimit të objekteve banesore në ato afariste, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme.

Lartësia e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore bazohet dhe llogaritet për m² të sipërfaqes (neto shfrytëzuese) për ndërtim.

Neni 28

Aplikanti duhet të paguan taksë për lëshimin e aktit për kushtet teknike dhe urbane për rregullimin e zonës, kjo vlen për tërë territorin e Komunës së Vitisë.

28.1 Tarifa e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në Komunën e Vitisë është unike për territorin e Komunës dy euro (2,00 euro) për metër katror

Neni 29**Benifitet për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore**

Investuesi nuk është obligues i kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në raste se:

29.1 Ndërton objekt të karakterit social, shëndetësor, arsimor ose fetar.

29.2 Ndërton objekt banimi për zgjidhjen e çështjes së banimit të familjes së ngushtë të dëshmorit ose të invalidit të luftës.

29.3 Ndërton objekt në pronësi shtetërore për nevoja të interesit të përgjithshëm.

29.4 Është shoqatë humanitare dhe ndërton objekt për destinime humanitare.

29.5 Rindërton objektin banesor të dëmtuar nga lufta ose fatkeqësitë tjera elementare sipas kategorisë IV dhe V të shkallës së dëmtimit, ndërton objektin investiv në pronësi komunale me mjete financiare si donacione nga organizatat- shoqatat humanitare apo të tjera.

29.6 Objekte të karakterit social, shëndetësor dhe arsimor nga paragrafi 1 të këtij neni konsiderohen objekte me interes të përgjithshme shoqërore që janë në pronësi shtetërore ku investitor është shteti apo donacionet të ndryshme për interes të përgjithshëm.

Investitori paragrafi 5 i këtij neni mundë të gëzoj të drejtën e lirimimit vetëm kur bënë ndërtim në lokacion, gabarit, tazhitet dhe destinim paraprak të objektit të dëmtuar.

Neni 30

Do të zvogëlohet lartësia e kompensimit të paraparë me këtë rregullore:

50% për ndërtimin – Rindërtimin e objekteve investive ekzistuese në sipërfaqe të njëjtë që posedojnë leje ndërtimi dhe dokumentacioni tjetër teknik.

Neni 31

Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore për lokalitet që nuk përfshihen në regjionin e gjërë të planit urbanistik për këto raste do të aplikohet tarifa përkatëse dhe llojit të objektit e zbritur për 50%.

Neni 32

Mjetet e inkasuara nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore nuk mundë të përdoren për qëllime tjera, përveç për rregullimin e tokës ndërtimore në Komunës e Vitisë.

Neni 33

33.1 Tarifa e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për objekte të përkohshme në Komunën e Vitisë

- Kompensimi për ndërtimin e objekteve të përkohshme montazh objekteve afariste 3.00€/m²
- Kompensimi për ndërtimin e objekteve të përkohshme afariste me material të fortë 3.00€/m²
- Kompensimi për ndërtimin e objekteve të përkohshme (garazhë, rrethojë, shupa) 2.00€/m²

Neni 34

Tarifa e kompensimit për marrjen e Lejeve Mjedisore Komunale (LMK) është 0.2% e vlerës së përgjithshme të projektit.

Për zbatimin e nenit 27 deri 34 të kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të mjedisit

Neni 35

Të gjitha taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale paguhen në bankë, në xhirollogarinë e buxhetit të Komunës së Vitisë, me përjashtim të taksave të cilat nuk kalojnë shumën prej 10,00 të cilat paguhen drejtpërdrejt në organin që kryen shërbimin.

Njësitë inkasuese të taksave administrative dhe komunale janë të obliguara që brenda 48 orëve të bëjnë dorëzimin e mjeteve financiare të inkasuar dhe t'i deponoj në xhirollogarinë bankare të komunës.

Neni 36

Sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 58, të gjitha të hyrat e mbledhura nga komuna janë para publike dhe menjëherë pasi të mblidhen duhen të deponohen në llogarinë e buxhetit të Komunës e pastaj zyrtari i autorizuar këto mjete i transferon në fondin e konsoliduar të Kosovës.

Mjetet e mbledhura mund të shpenzohen vetëm pas alokimeve nga MFE.

Neni 35 dhe 36 janë të obliguar ta zbatojnë të gjitha Drejtoritë komunale.

Neni 37

GJOBAT NGA TRAFIKU

Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtje në trafik, i takojnë komunës. Alokimi i mjeteve të inkasuara bëhet sipas dispozitave të rregullativës për thesarin. Mjetet e inkasuara mund të jenë si rrjedhojë e inkasimit të tyre nga dënimet mandatore, përmes SHPK-së dhe vendimeve përfundimtare të gjykatës për kundërvajtje.

Neni 38

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Personat fizik dhe juridik të cilët me dashje apo nga pakujdesia nuk i përmbushin obligimet në mënyrën, kohën dhe vendin e përcaktuar sipas dispozitave të kësaj rregullore do të dënohen me dënim me gjobë në të holla, varësisht nga përgjegjësia dhe përgjegjshmëria e subjekteve të ngarkuara me taksa, tarifa dhe ngarkesa tjera sipas parimit të fajësisë.

Neni 39

Personat zyrtar në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe autorizimeve publike dhe me qëllim të zbatimit të dispozitave të kësaj rregullore mund të inicojnë procedurë kundërvajtëse dhe të propozojnë shqiptimin e dënimit me gjobë ndaj subjekteve të cilat nuk i përmbushin obligimet mbi pagimin e taksave dhe ngarkesave sipas kësaj rregullore të gjitha këto në rrugë gjyqësore.

Neni 40

Do të dënohet për kundërvajtje personi fizik dhe juridik me dënim me gjobë për shkelje të dispozitave të rregullores mbi taksat dhe tarifat dhe atë si në vijim:

- 40.1. Me gjobë prej 500 € deri 800 € dënohet personat fizik ndërsa 800 € deri 1600 € do të dënohet personat juridik nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 12.1.1 pika a, b, c dhe d të kësaj rregullore.
- 40.2. Me gjobë prej 4 € për m² deri me 6 € m² do të dënohen personat juridik dhe fizik që veprojnë në kundërshtim me nenin 12.1.3 dhe 12.1.4 të kësaj rregullore.
- 40.3. Me gjobë prej 30 € deri 50 € do të dënohen personat juridik dhe fizik që veprojnë në kundërshtim me nenin 13.2.8 pika a), dhe neni 13.2.9 pika a), b), c), d) të kësaj rregullore.
- 40.4. Me gjobë prej 50 € deri 100 € për persona fizik, ndërsa për persona juridik prej 100 € deri 200 € do të dënohen nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 13.3. pikat (1), (2), (3), (5), (7), (8) dhe neni 13.3.12 pika a, b dhe c të kësaj rregullore.
- 40.5. Kompanitë publike që ndërhyjnë në infrastrukturën publike për punë të kontraktuat me komunën gjatë ndërhyrjes në infrastrukturës si dhe kompanitë publike që ofrojnë shërbime publike në rast mos kthimit në gjendjen e mëparshme të infrastrukturës publike të dëmtuar do të zbatohen nenet 13.3.12 dhe 13.2.11 të rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba.
- 40.6. Të gjitha subjektet të cilat nuk i përgjigjen pagesës së tarifës dhe ngarkesave Komunale të paraparë me këtë Rregullore, do të kërkohet ekzekutimi i dhunshëm nëpërmes Gjykatës kompetente.

Neni 41

41.1 Me dënim me gjobë prej 500€ deri 700€ do të dënohen për kundërvajtje personat fizik dhe juridik për mos pagesën e taksës komunale të përcaktuar në dispozitat e rregullores si vijon 21.1.1, 21.1.2, 21.1.5, 21.1.6, 21.1.7, 21.1.8, 21.1.9, 21.1.10, 21.1.11, 21.1.12, 21.1.13, 21.1.14, 21.1.15, 21.1.16, 21.1.18, 21.1.20, 21.1.23, 21.1.24, 21.1.25, 21.1.27, 21.1.29, 21.1.32, 21.1.33, 21.1.34, 21.1.35, 21.1.36, 21.2.2, 21.2.3, 21.2.5, 21.2.6, 21.2.10, 21.2.11, 21.2.12, 21.2.18, 21.2.30, 21.2.36, 21.2.39, 21.2.54, 21.2.55, 21.2.56, 21.2.57, 21.2.58, 21.2.59, 21.2.60, 21.2.61, 21.2.62, 21.2.63, 21.2.64, 21.2.65, 21.2.67, 21.3.1, 21.3.2, 21.3.3, 21.3.4, 21.3.5, 21.4.1, 21.4.2, 21.4.3, 21.4.4, 21.5.1, 21.5.2, 21.5.3, 21.5.4, dhe 21.5.5.

41.2 Me dënim me gjobë prej 300€ deri në 500€ do të dënohen për kundërvajtje personat fizik dhe juridik për mospagesën e taksës komunale të përcaktuar sipas dispozitave të rregullores si në vijim: 21.1.3, 21.1.4, 21.1.17, 21.1.30, 21.1.37, 21.1.38, 21.1.39, 21.2.1, 21.2.8, 21.2.9, 21.2.14, 21.2.15, 21.2.20, 21.2.23, 21.2.24, 21.2.25, 21.2.26, 21.2.27, 21.2.28, 21.2.33, 21.2.34, 21.2.37, 21.3.6, 21.3.7, dhe 21.3.8.

41.3 Me dënim me gjobë prej 200€ deri në 400€ do të dënohen për kundërvajtje personat fizik dhe juridik për mospagesën e taksës komunale të përcaktuar sipas dispozitave të rregullorës si në vijim: 21.1.19, 21.1.21, 21.1.22, 21.1.26, 21.1.28, 21.1.31, 21.2.7, 21.2.13, 21.2.16, 21.2.17, 21.2.19, 21.2.21, 21.2.22, 21.2.29, 21.2.32, 21.2.35, dhe 21.2.66.

41.4 Me dënim me gjobë prej 250€ deri në 400€ do të dënohen për kundërvajtje personat fizik që kryejnë shërbime profesionale për mospagesën e taksës komunale të përcaktuar sipas dispozitave të rregullorës si në vijim: 21.2.40, 21.2.41, 21.2.42, 21.2.43, 21.2.44, 21.2.45, 21.2.46, 21.2.47, 21.2.48, 21.2.49, 21.2.50, 21.2.51, 21.2.52, dhe 21.2.53.

Neni 42

DISPOZITAT KALIMTARE

Për të gjitha rastet kur me dispozitat ligjore shprehimisht janë paraparë taksa, ngarkesa dhe gjoba në raport me rregulloren komunale mbi taksat ngarkesat dhe gjobat, vlejnë dispozitat ligjore dhe udhëzimet përcjellëse të zbatimit të këtyre dispozitave, në të gjitha rastet tjera vlejnë dispozitat e kësaj rregullore.

Neni 43

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen. Kjo rregullore fillon të zbatohet nga data: 01.01.2020, deri me datën: 31.12.2020, me fillimin e zbatimit të kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja për taksa ngarkesa dhe gjoba nr. 01-110/05-997 e datës 28.09.2018.

Viti, më 26.09.2019

KUVENDI I KOMUNES SË VITISË

